



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT LEZHË

V E N D I M

Nr. 53, datë 04.12.2015

"PËR EMERTIMIN E TITUJVE TË NDERIT"

Bazuar në ligjin 8652 dt 30.07. 2000, "Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore, i ndryshuar, Ligjin nr. 112/2013, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e KM nr. 861 , datë 10.12.2014, "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", dhe me propozim të Komisionit Këshillimor për Dhënien e Titujve të Nderit , pas diskutimit të anëtarëve, Këshilli i Qarkut Lezhë

V E N D O S I:

1. Të jape titujt e nderit si vijon:
 - 1.1. NDERI I QARKUT LEZHË. Me këtë titull të nderohen individë (edhe pas vdekjes) apo institucione veprimtaria e të cilëve ka pasur ose ka ndikim shumë pozitiv në zhvillimin historik, shkencor, kulturor, social e sportiv në Qarkun e Lezhës.
 - 1.2. MIRËNJOHJA E QARKUT LEZHË. T'u jepet individëve, organizmave e institucioneve që kanë dhënë ose japin ndihmesa të veçanta, në fusha të ndryshme të zhvillimit social ekonomik të Qarkut të Lezhës.
 - 1.3. MIK I QARKUT LEZHË. T'u jepet individëve të huaj e vendas (jashtë Qarkut Lezhë), që kanë shpalosur frymë miqësore dhe kanë promovuar vlerat e mikpritjes e traditës në Qarkun e Lezhës
2. Shfuqizimin e Vendimit Nr. 21 datë 08.05.2008 "Për emërtimin e titujve të nderit"
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Këshillimor , Sektori Juridik dhe Sektori i Finances në Këshillin e Qarkut.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEKRETARI

Esmeralda NDOKA

Nr 1466 Prot

Date 4.12/2015

